




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN



Duke vendosur në çështjen administrative, sipas Kërkesës për Rishqyrtim të dt. 17.09.2020, parashtuar nga subjekti në procedurë: " Premium Bakery 'sh.p.k. me seli në Graçanicë, Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik e Komunës së Vushtrrisë, pas mbajtjes së seancës jo publike të shqyrtimit të kërkesës të subjektit në fjalë, në bazë të nenit 108/A pika 10 paragrafi 10.1 të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 lidhur me nenin 3.1 dhe 7 pika (b) të Rregullave për , më datën 03.12.2019, merr këtë:

V E N D I M

- 1. Hedhet poshtë si e papranueshme** Kërkesa për Rishqyrtim e parashtuar nga subjekti në procedurë, **O.E " Premium Bakery "sh.p.k. me seli në Graçanicë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: " Furnizimi me shujtë ushqimore për nxënësit e nivelit parafillorë dhe fillorë "** prok. Nr. 644 – 20 – 4129 – 1-1-1 dhe Nr. i brendshëm : 644 – 20 – 047 – 111 **për shkak të mungesës së legjitimacionit të palës.**
- 2. Vërtetohet si i bazuar** Vendimi i Autoritetit Kontraktues – Drejtorisë Komunale për Prokurim Publik për vazhdimin e aktivitetit në bazë të Njoftimit për Kontratë të dt 06.08.2020 dhe Raportit të hapjes së ofertave të dt. 15.09.2020

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik (në tekstin e mëtejme A.K.) në bazë të Kërkesës së Njësisë Kërkuese ka iniciuar aktivitetin e prokurimit me titull : Furnizimi me shujtë ushqimore për nxënësit e nivelit parafillorë dhe fillorë, prok. Nr. 644 – 20 – 4129 – 1-1-1 dhe Nr. i brendshëm : 644 – 20 – 047 – 111.

Njoftimi për Kontratë (në tekstin e mëtejme Njoftimi i A.K.) është dërguar për publikim në platformën elektronike më dt. **06.08.2020**, bazuar në dispozitat e nenit 40 të LPP-së .

Autoriteti Kontraktues ka pranuar Kërkesën për Rishqyrtim nga O.E. : " Premium Bakery "sh.p.k., në tekstin e mëtejme (Ankuesi).

Pasi A.K. fillimisht ka shqyrtuar afatshmërinë dhe pranueshmërinë e Kërkesës për Rishqyrtim, A.K. ka konstatuar se Kërkesa e OE " Premium Bakery "sh.p.k. është e papranueshme, sepse Kërkesa për Rishqyrtim e O.E., është e orientuar me pretendime ankimore të cilat nuk ndërlidhen me përmbajtjen, kushtet, kriteret dhe Specifikat Teknike të saktësuara në dokumentet e tenderit dhe / ose në Njoftimin për Kontratë dhe / ose Specifikat Teknike të saktësuara si në Aneksin 1 – Specifikat Teknike të Detyrueshme. Kjo nuk është në pajtim me dispozitat e nenit 3 pika 3.1 të Rregullave për paraqitjen e kërkesës për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, pasi që Kërkesa për Rishqyrtim e O.E. duhet të ndërlidhet me Njoftimin për Kontratë, dokumentet e Tenderit, ose Njoftimet dhe vendimet tjera gjatë kryerjes së aktivitetit përkatës të prokurimit.

Po ashtu palës i mungon legjitimacioni pasiv pasi që Ankuesi nuk është palë në këtë procedurë, nuk ka marrë pjesë në këtë aktivitet të prokurimit, andaj A.K. konsideron se nuk ka bazë për shqyrtim të mëtejme të Kërkesës dhe me të drejtë e hedhë poshtë si të papranueshme.

Pretendimet e Ankuesit se vetëm ekziston një kontratë e lidhur mes Agjencionit Qendrorë për Prokurim, në tekstin e mëtejme (AQP) në njërën anë dhe Ankuesit për furnizim me kiflet (shujtë ushqimore), në anën tjetër, dhe sikurse pretendon Ankuesi ne si A.K. kemi obligim ta zbatojmë këtë kontratë duke propozuar që të ndërpresim aktivitetin e prokurimit, sikurse ka vlerësuar A.K. nuk janë të qëndrueshme dhe si të tilla janë të pabazuara për faktin se :


1. Shujta sipas kontratës me AQP-n , sikurse sqaron drejtuesi i Njësisë Kërkuese të A.K.. është e dedikuar vetëm për fëmijë të nivelit parafillor të cilët qëndrojnë në çerdhe, e jo për fëmijët që janë në klasat përgatitore dhe fillore deri në klasën e pestë, SIKUSRSE Është rasti me aktivitetin e prokurimit të iniciuar nga A.K.
 2. A.K. e respekton Kontratën me AQP-n dhe do ta zbatoi me përpikmëri, duke marrë parasysh edhe kërkesën e saj qyshe në vitin 2018 për lidhjen e një kontrate nga AQP-ja.
 3. Kontrata për furnizim me bukë dhe brumëra te tjerë, e lidhur nga AQP rezulton nga Kërkesat e Autoriteteve te nivelit local dhe qendrore, ne mesin e te cilave jemi edhe ne si Autoritet Kontraktues dhe te cilës I përmbahemi me përpikmëri bazuar ne kërkesat e saktësuar të drejtuara AQP-se ne vitin 2018. Sipas Kerkesave te A.K. – Komunës se Vushtrrisë rezulton se sasia e kifleve të llojit te ndryshem, siapas Specifikave teknike, e planifikuar eshte ne sasi, si vijon : 1500 cope kifle Krosant dhe 8400 cope kifle me gjem, dhe ket kryesisht per nevoja AD HOC qe paraqiten tek Qerdhja e fesmijeve “ Foleja “ ne Vushtri.
 4. Projekti për furnizim me shujtë ushqimore për nxënësit e niveleve parashkollor dhe fillor është i llojit Kontratë Publike Kornizë, nuk ka qen I planifikuar të zhvillohet në vitin 2018, si I till ky project ka filluar të implementohet në vitin 2019, ku edhe ka pasur nënshkrim të kontratës, e cila është realizuar nga qershori i vitit 2019, me saasit e përafërta prej 1,170,000.00 copë, ndërsa edhe në këtë vit 2020, duke qenë se projekti në njesin kërkuese – drejtorin e Arsimit ka qenë i planifikuar, i njeiti projekt me kërkesë të Drejtorisë së Arsimit, është inicuar.
 5. Marë parasysh natyrën e Kontratës Publike Kornizë, sasitë e parashikuara të shujtës sipas Kontrataës me AQP-n dhe sasitë e prashikuara sipas aktivitetit të Prokurimit të A.K. të sqaruara si në pikën 4 të këtij Vendimi, bazuar në dispozitat e nenit 56 pika 56.10 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik (RUOPP)se, citat : “ **Sasia e parashikuar e specifikuar në dokumentet e tenderit është vetëm sasi indikative. Kurdo qe Autoriteti kontraktues specifikon sasinë indikative, Autoriteti kontraktues do të specifikojë në dosjen e tenderit vlerën ose sasinë e kontratës si një prag apo një tavan dhe do të lejojë devijimin prej tij, duke deklaruar gjithashtu përqindjen e mospërputhjes së lejuar. Mospërputhja e lejuar nuk mund të jetë më e lartë se plus/minus tridhjetë përqind (30%). Nëse urdhër blerjet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të kontratës publike kornizë (duke përfshirë + tridhjetë përqind (30%), pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të Kontratës Publike Kornizë, kontrata do të ndërpritet automatikisht”mbarim citati, A.K. vërteton se sitë e parashikuara me Kontratën e AQP-së nuk përmbushin kërkesat e A.K. as përsëafërmi, më së shumti 1.5 muaj.**
 6. Natyra e ekzekutimit të kontratës e lidhur nga AQP dhe kontratës që po synohet të lidhet nga A.K. janë krejtësisht të ndryshme nga se kontrata me AQP-në realizohet në sasi shumë të vogla sipas nevojës së paraqitur AD HOC nga njësia këkuese, ndërsa kontrata që ne po suynojm të lidhim duhet të realizohet ç’do ditë pune dhe atë në dy ndrrime sipas orareve në secilen shkollë brenda territorit të komunës së Vushtrrisë.
 7. E njëta sasi e përafërt e kifleve të ndryshme (katër lloje sipas përmbajtjes së mbushjesë) prej rreth 1,170,000.00 copë është planifikuar edhe për vitin shkollorë 2020-2021 ku çmimi I parashikuar për një cope kifle është shumë më I ulët se sa çmimi I kontraktuar sipas kontratës së AQP-së, çmim ky I cili, sikurse sqaron Njësia Kërkuese e A.K., nuk mund të përballohet me buxhetin e Drejtorisë së Arsimit të parashikuar për këtë aktivitet të prokurimit.
 8. Po ashtu çmimet e Ankuesit të kontraktuara sipas AQP-së për artkuj si në aktivitetin e prokurimit janë në shumë prej 0.15€ deri në 0.17€ ndërsa, çmimet e artikujve të njëjtë sipas ofertave të pranuar respektivisht të hapura janë nga 0.08€ deri në 0.10€. Çmimet e Ankuesit, sikurse vlerëson Njësia e Kërkesës, janë të papërbalueshme dhe për rrjedhojë të papranueshme në aspektin financiar për shkak të mungesës ë buxhetit të parashikuar.
- Nga sa u tha me lartë, e në përputhje me nenin 108/A pika 10 paragrafi 10.1 të LPP-së u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komonale për Prokurim Publik

K.R. nr. 047/2020 - datë 21/09/2020

Aktvendimi i dërgohet:

Drejtoria për Prokurim Publik


Hyda Dallku, ZPP

1. 1x Palës
2. 1 x DKP
3. 1 x Arkivit (1 kopje)